

**ALBCONTROL SH.A ( ISH A.N.T.A)**

Drejtuar: Operatorit ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS” sh.p.k, me me Nipt K21710002J, me adresë: Murat Toptani, Eurocol Center, Kati 8.

Procedura e prokurimit/lotit: Procedure e hapur.

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-05132-05-17-2024.

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje UPS dhe bateri per UPS per te gjitha objektet e kompanise”, me nr. REF- 05132-05-17-2024, me fond limit 15 204 673 (pesembëdhjetë milion e dyqind e kater mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë pa tvsh.

Kohëzgjatja e kontratës do të jetë: 3 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike nuk ka

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Ofertuesi i parë: Operatori Ekonomik: “4 A-M” me Nipt K92005016L.
  - Çmimi i ofertës: 25,721,000 (njezet e pesëmilion e shtatëqind e njëzetënjëmijë) lekë pa tvsh.
2. Ofertuesi i dytë: Operatori Ekonomik: “Advanced Business Solutions – ABS” me Nipt K21710002J.
  - Çmimi i ofertës: 13,092,000 (trembëdhjetë milion e nëntëdhjetë e dymijë) lekë pa tvsh.
3. Ofertuesi i tretë: Operatori Ekonomik: “Hellas Servis” me Nipt J82313002T.

- Çmimi i ofertës: 14,993,754.40 (katërbëdhjetë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e katër pikë dyzet) lekë pa tvsh.
4. Ofertuesi i katërt: Operatori Ekonomik: “Ratech” me Nipt L11521021S.
- Çmimi i ofertës: 13,447,100 (trembëdhjetë milion e katërqind e dyzet e shtatëmijë e njëqind) lekë pa tvsh.
5. Ofertuesi i peste: Operatori Ekonomik: “ASI Invest”.
- Çmimi i ofertës: Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik: 4 A-M, me Nipt K92005016L.
  - ✚ Operatori ekonomik nuk ka ngarkuar në SPE sigurimin e ofertës sipas Shtojcës 3 dhe Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8.
  - ✚ Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për pikën 2.2.1 të kapacitetit ekonomik dhe financiar, kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: 2021, 2022, 2023 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore.
  - ✚ Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.1, të kapacitetit teknik, pasi në dokumentacion e ngarkuar në SPE, operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit.
  - ✚ Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.4, të kapacitetit teknik, pasi në dokumentacion e ngarkuar në SPE, operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për certifikate cilesie CE për bateritë e ofertuara, për mallrat objekt prokurimi.
  - ✚ Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.5, të kapacitetit teknik, pasi në dokumentacion e ngarkuar në SPE, operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për staf të punësuar të paktën 3 inxhinierë elektrike dhe/ose elektronike për të garantuar implementimin në kohë të projektit, në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.
  - ✚ Oferta ekonomike është plotësuar më e lartë se fondi limit në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit.
2. Operatori Ekonomik: Hellas Servis, me Nipt J82313002T.
  - ✚ Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.4, të kapacitetit teknik, pasi në dokumentacion e ngarkuar në SPE, operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për certifikate cilesie CE për bateritë e ofertuara, për mallrat objekt prokurimi.
  - ✚ Operatori ekonomik nuk plotëson pikën 2.3.6, të kapacitetit teknik, pasi në dokumentacion e ngarkuar në SPE, operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokumentacion për katalogun/ët teknik për mallrat që do të furnizojë për këtë objekt prokurimi në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike.
  - ✚ Operatori ekonomik nuk ka ngarkuar në SPE sigurimin e ofertës sipas Shtojcës 3 dhe Vertetimin për xhiron për 3 vitet e fundit financiare (2021,2022,2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël 40% e vlerës së fondit limit dhe nuk ka detajuar Formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit për punonjësit që do të përfshiheshin në përmbushjen e kriterit 2.3.5.

3. Operatori Ekonomik: ASI Invest,

- ✚ Pas hapjes së ofertave, u konstatua se OE nuk ka paraqitur në SPE asnjë dokument për të dëshmuar se plotëson kriteret e kualifikimit të kërkuar në DST. Në dokumentacion e ngarkuar në SPE operatori ekonomik ka ngarkuar vetëm ekstraktin e regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë: Operatorin ekonomik “Advanced Business Solutions - ABS”, me me Nipt K21710002J, me adresë: Murat Toptani, Eurocol Center, Kati 8, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 13,092,000 (trembëdhjetë milion e nëntëdhjetë e dymijë) lekë pa tvsh, është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë ALBCONTROL SHA me adresë: Aeroporti “Nënë Tereza”, Rinas me Nr.Tel. +355 (0) 44542101, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit te Fituesit (Paraparak)

PO  JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)\_\_\_\_\_

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO  JO X

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë)\_\_\_\_\_